

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, përmes gjyqtarës së vetme gjyquese Snezhana Mihajloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.Z. nga ..., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.66/2018 të datës 17.01.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më dt. 21.03.2018, në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A.Z.** nga babai R. dhe nëna H. – S., i lindur më dt. ..., në ..., ku edhe jeton, rr. “ ... ” nr. ..., i pamartuar, i arsimuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

ËSHTË FAJTOR

Sepse më dt. 02.01.2018 rreth orës 12:00 minuta, në rrugën Gjilan-Velekincë, në lagjen “ ... ” përballë autolarjes “ ... ” duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës “ ... ” me ngjyrë ... dhe targa të regjistrimit, numri i targave... ka shkelur paragr. 1 të nenit 53 dhe nënparagr. 1.2 paragr.1 të nenit 54 Ligji Nr.05/L-088 mbi Rregullat e Trafikut Rrugor dhe me këtë e ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke e drejtuar automjetin e lartpërmendur nuk i është përmbajtur dispozitave të lartpërmendura të ligjit në fjalë që kanë të bëjnë me obligimin e shoferit sipas të cilit “shoferi duhet ta përshtatë shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe fushëpamjes së rrugës, gjendjes dhe llojit të rrugës, kushteve teknike, atmosferike, ngarkesës së mjetit dendësisë së trafikut, gjendjes psikofizike të tij dhe aftësive personale të tij, ashtu që të jetë në gjendje ta ndal mjetin para çdo pengese që mund të paraqitet në kushte të dhëna brenda kufijve të fushëpamjes, përkatësisht, të mund të veprojë me kohë” dhe atë sipas të cilit “të mbajë distancë të nevojshme nga mjete përpara aq sa është e nevojshme për t’iu shmangur goditjes së mjetit, nëse mjete përpara frenon apo ndalet” lehtë ka menduar se edhe përkundër këtyre lëshimeve nuk do të shkaktoj pasoja të ndaluara, ashtu që me të arritur në vendin e përmendur, me kohë nuk ka mundur ta ndal automjetin e tij të lartpërmendur dhe për pasojë me pjesën e përparme të anës së djathtë e godet mbrapa automjetin e markës “ ... ” me ngjyrë të ... dhe targa të regjistrimit, numri i targave... të cilin me këtë rast ishte duke e drejtuar i dëmtuari M.A. nga ..., më pas kalon në shiritin e kundërt të qarkullimit dhe ndeshet me pjesën e përparme të anës së majtë të automjetit transportues-kamionetën e markës “ ... ” me targa të regjistrimit, numri i targave... të cilin me këtë rast e drejtonte i dëmtuari S.B. nga ..., dhe përveç dëmit material i cili është shkaktuar në automjetet e lartpërmendura të dëmtuarve, në vlerë të papërcaktuar, lëndime të lehta trupore në formë të ndrydhjeve në indet e buta të kokës dhe abdomenit – ana e djathtë, me pasoja të përkohshme për shëndetin i kishte shkaktuar edhe bashkudhëtarit B.S. nga

- me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr. 6 lidhur me paragr. 1 KPRK.

E GJYKON

I. ME DËNIM GJOBE në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit, në të kundërtën gjykata të njëjtin dënim do t'ia zëvendësoj me dënim burgu, ashtu që një ditë burgu do të llogaritet 20 €.

II. Të dëmtuarit M.A. nga ..., rr. " ..." dhe S.B. nga ..., rr. " ... ", për realizimin e kërkesë pronëso-ro-juridike, udhëzohen në kontestin civil.

III. I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga 25 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

IV. I akuzuari obligohet që në bazë të nënparagr.3.1 të Ligjit mbi Kompensimin e Viktimave të Krimin, në emër të taksës për kompensim, të paguaj shumën prej 30 €.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritë aktakuzën kundër të akuzuarit A.Z. nga ..., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1KPRK, me propozim që gjykata të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta ndëshkoj sipas ligjit.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më dt. 21.03.2018 prokurorja e shtetit Sllavica Popoviq ka deklaruar se i akuzuari e ka pranuar veprën penale dhe se këtë e ka bërë me vullnetin e tij të lirë, andaj, i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe t'i shqiptoj dënim sipas ligjit.

Të dëmtuarit M.A. dhe S.B. për realizimin e kërkesës pronëso-ro-juridike udhëzohen në kontestin civil.

I akuzuari A.Z. ka pranuar fajësinë dhe veprën penale e cila i vihet në barrë, duke shtuar se më parë nuk ka qenë i gjykuar, se është i gjendjes së mesme ekonomike, i vjen keq për aksidentin i cili ka ndodhur, se më të dëmtuarit është marr vesh lidhur me kompensimin e dëmit, se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm në vozitje dhe se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo vepra tjera penale, andaj, lutë gjykatën që ta dënoj sa më butë.

Në seancën fillestare, gjykatësja e vetme gjykuese pas deklarimit të palëve mori Aktvendim me të cilin aprovoi pranimin e fajësisë, pasi që ka konstatuar se për këtë gjë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Gjykatësja e vetme ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi është bërë me vullnetin e tij, se pranimi i fajësisë përmban të gjitha faktet të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë të metë ligjore apo gabime faktike.

Konform kësaj, gjyqtarja e vetme vërtetoi gjendjen faktike: se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në bazë të nenit 73 dhe 74 KPRK me rastin e shqyrtimit të dënimit kundër të pandehurit A.Z., gjyqtarja e vetme gjykuese mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat

ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që nga rrethanat lehtësuese gjykata i mori parasysh se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, sjelljen e tij korrekte në gjykatë, se pendohet për kryerjen e veprës penale, se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo tjera vepra penale dhe se më të dëmtuarit është marr vesh lidhur me kompensimin e dëmit. Rrethana rënduese nuk pati.

Sipas bindjes së kësaj gjykate shqiptimi i dënimit me gjobë ndaj të pandehurit A.Z., e duke pasur parasysh rrethanat e cekura më lart, i është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, po ashtu konstatoi se me këtë lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit nga neni 41 KPRK që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra tjera penale, t'i parandaloj personat tjerë në kryerjen e veprave penale dhe të paraqes gjykimin shoqëror për veprën penale, të rris moralin dhe fuqizoj obligimin për të respektuar ligjin.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr në bazë të nenit 453 KPRK.

Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.69/2018 më dt. 21.03.2018**

**Sekretarja juridike,
Suzana Kovaçević**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Snezhana Mihajloviq**

UDHËZIMI JURIDIK: *Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.*

**Përktheu –
Naile Keçmezi**

